

VENDIM
Nr.78, datë 19.11.2008

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c”, “f” dhe shkronja “g”, dhe nenit 76 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 13, paragrafi i parë, pas togfjalëshit “... të njëpasnjëshëm të tyre, ...”, shtohet togfjalëshi “...në Buletin Zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik, ...”;

b) në nenin 20, paragrafi i tretë, togfjalëshi “...do t’u kërkohet vendimi i gjykatës për regjistrimin si person fizik tregtar ose juridik, si dhe certifikata e regjistrimit në organin tatimor,...” zëvendësohet me togfjalëshin “....do t’u kërkohet vërtetimi për regjistrimin si person fizik tregtar ose juridik,...”;

c) në nenin 30, paragrafi i parë, pas togfjalëshit “... do të jetë 10”, shtohet togfjalëshi “...deri 20 ...”;

d) neni 36, paragrafi i katërt ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Komisioni i prokurimit sipas objektit konkret të prokurimit, duke gjykuar dhe argumentuar vetë rëndësinë, natyrën e punës, kushtet teknike apo specifike tepër të veçanta të mallit të kërkuar apo ekzistencën e një strategjie apo politike të miratuar nga Banka e Shqipërisë, dhe mbështetur sipas rastit në argumentimet e bëra në kërkesën për prokurim të departamentit apo strukturës përkatëse të Bankës së Shqipërisë, mund të përcaktojë markat e mallrave, qoftë si kategori “*brand name*” qoftë si markë e individualizuar, duke marrë në çdo rast miratimin me shkrim nga Kryetari i Entit Prokurues. Në prokurimin e mallrave me markë të individualizuar, komisioni synon të prokurorë direkt me prodhuesin ose sipas njoftimit të këtij të fundit, me përfaqësuesin e autorizuar të tij.

e) në nenin 40 shtohet shkronja “d” sipas përmbajtjes së mëposhtme:

d) mungon kryetari i Komisionit dhe është i pamundur zëvendësimi i tij;

f) në nenin 40 shtohet paragrafi i tretë sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Për rastin e parashikuar në shkronjën “d” anëtari më i vjetër në moshë do të mbledhë dhe kryesojë mbledhjen e Komisionit të Prokurimit për shtyrjen e procedurës dhe caktimin e një date të re, e cila do të jetë jo më pak se 5 ditë pas datës së planifikuar për hapjen e ofertave.

g) në nenin 41, pika 1, shkronja “a” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

a) ka mungesë konkurrence midis kandidatëve kur paraqitet vetëm një ofertues ose nuk paraqitet asnjë i tillë;

h) Në nenin 41, pika 1, shkronja “b” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

b) të gjithë ofertuesit nuk kalojnë fazën e kualifikimit ose e kalon vetëm njëri prej tyre;

i) në nenin 41, pika 1, shkronja “c” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

c) asnjë kuotim ose ofertë e sjellë nuk plotëson kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të kërkuara nga Banka e Shqipërisë ose i plotëson vetëm njëra prej tyre;

j) në nenin 49, shkronja “a”, shtohet pika e parë me këtë përmbajtje:

- ndarjen në lote të objektit të prokurimit kur çmohet e nevojshme;

k) në nenin 51, pas togfjalëshit “...institucione të tjera shtetërore përkatëse”, shtohet togfjalëshi “ ... kur ky informacion është i disponueshëm”;

l) në nenin 51, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafe sipas përmbajtjes së mëposhtme:

- Në rastet e prokurimit të drejtpërdrejtë, studimi i tregut realizohet vetëm me ofertën e kandidatit të ftuar.

- Në rast përsëritjeje të procedurës së prokurimit, ofertat mbi studimin e tregut mund të përdoren si bazë në studimin pasardhës, kur përsëritja e procedurave, të prokurimit realizohet brenda tre muajve nga data e studimit të parë të tregut.

m) Në nenin 51, paragrafi i parafundit ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Procedurat e prokurimit, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, mbikëqyren nga juristi i angazhuar në procedurën e prokurimit, i cili konfirmon rregullsinë e procedurës në procesverbalet e mbledhjeve dhe në vendimin e Komisionit të Prokurimit.

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit dhe strukturat e tjera të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani